



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije
Ministrio of Education, Science and Technology

Raport nga konferenca ndërkombëtare në Sarajevë, me temën:

” Drejt Mundësive të Barabarta për fëmijët Romë në Evropën Juglindore –
Modelet e Praktikës së Mirë në Edukimin Gjithëpërfshirës dhe Anti-
diskriminimit”

Në organizatën Save the Children më përkrahjen e Këshillit të Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës, Save the Children Norvegji dhe OSCE, është organizuar konferenca ndërkombëtare në Sarajevë me temën ” Drejt Mundësive të Barabarta për fëmijët Romë në Evropën Juglindore – Modelet e Praktikës së Mirë në Edukimin Gjithëpërfshirës dhe Antidiskriminimit” më 2 dhe 3 prill.

Në konferencë kanë marrë pjesë përfaqësuesit e qeverive të shteteve të Evropës Juglindore dhe anëtarët e shoqërisë civile, donatorët, për të diskutuar çështjen e gjithëpërfshirjes së romëve.

Nga Kosova kanë qënë vetem dy pjesëmarrës, një nga MASHT-i dhe një nga shoqëria civile. MASHT ka prezentuar të gjitha ato që janë bërë në fushën e edukimit të minoriteteve dhe posaçërisht komunitetit RAE me qëllim të ngritjes së nivelit në arsimimin dhe integrimin e tyre. Gjithashtu për mësimin intensiv, për regjistrimin e komuniteteve në UP në bazë të kvotave, për Strategji për Integrimin e komunitetit RAE, komponenta e arsimit dhe janë shprehëndarë kopje të Strategjisë në gjuhën shqipe, angleze, romë dhe serbe. Konferenca ka qënë shumë mirë e organizuar dhe e dobishme, me ekspertiza të ligjëruesve nga Anglia dhe prezentimet e tyre.

Prezentimet në sesionet plenare ishte rreth arritjeve dhe tendencave për të ardhmën në fushën e arsimit të komunitetit rom, i cili ka mbetur në nivelin më të ulët të arsimit në rajon.

Pjesëmarrësit e konferencës kanë theksuar që edhe pse qeveritë e EJK-së kanë bërë veprime dhe kanë përgatitur strategji në përkrahje të gjithëpërfshirjes së minoriteteve, posaçërisht të romëve, në shoqëri progresi i arritur është i pamjaftueshëm për të luftuar diskriminimin. Janë nxjerrë konkludime të cilat janë të përqendruara në përmirësimin e gasjes në edukim, si dhe përmirësimin e kualitetit të edukimit për fëmijët romë përmes:

- Ngritjes së vetëdijes për rëndësinë e edukimit të fëmijëve romë
- Njoftimit të prindërve romë për të drejtat e tyre, obligimet dhe zbatimin e qëndrueshmërisë së ligjeve të edukimit që kanë lidhje me fëmijët e tyre.

- Monitorimin e fëmijëve të regjistruar në shkolla dhe parandalimi e braktisjes në kohë të duhur.
- Prezantimit të klasave përgatitore dhe bursave për fëmijët e minoritetëve.
- Përkrahje në zhvillimin e kulturave gjithëpërfshirëse, politikave dhe praktikave në nivel të shkollave që kujdesen dhe ndihmojnë në integrimin e fëmijëve romë.